



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 15 shtator 2021

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 19 dhe të rregullit 20 të Rregullores së punës Nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; si dhe në mbështetje të Rregullores Nr. 04/2015, për Procedurat e rekrutimit, të emërimit dhe të punës provuese të stafit të Gjykatës Kushtetuese, dhe Rregullores Nr. 01/2016 për avancimin dhe transferimin e stafit të GjKK-së, Sekretariati shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM

Pozita:	Specialist i Shërbimeve Gjuhësore
Kodi:	SP-DPP 03/02
Numri i pozitave:	2(dy)
Kohëzgjatja e emërimit:	I karrierës (pa afat)
Puna provuese:	1 (një) vit

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe në bashkëpunim me Menaxherin për koordinimin e përkthimeve, specialisti i shërbimeve gjuhësore kryen kontrollin e përputhshmërisë së përkthimit me origjinalin e aktgjykimeve, aktvendimeve dhe vendimeve të tjera të Gjykatës, kryen përkthimin simultan si dhe adreson kërkesat për përkthim nga shqipja në serbisht dhe në anglisht, dhe anasjelltas, duke siguruar cilësinë dhe përputhshmërinë e përkthimit me dokumentin origjinal në aspekt të kuptimit dhe të gramatikës. Gjithashtu, shërben si person konsultues për harmonizimin e terminologjisë juridike në gjuhët përkatëse në dokumentet e Gjykatës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Kryen kontrollin e përkthimit të dokumenteve të kategorive të specifikuara, në veçanti projekt aktgjykimeve dhe dokumenteve tjera të ndjeshme;
2. Me anë të rishikimit dhe kontrollit të cilësisë, sigurohet që cilësia e versionit të përkthyer përputhet me origjinalin, është e kuptueshme dhe gramatike dhe saktë;
3. Ofron përkthim simultan gjatë takimeve të nivelit të lartë, Seminareve, Konferencave dhe seancave gjyqësore nga shqipja në serbisht dhe anglisht, dhe anasjelltas;
4. Siguron përkthimin e brendshëm të Aktgjykimeve, Aktvendimeve, Rregulloreve, Raporteve dhe dokumenteve të tjera të ndjeshme;
5. Personi konsultues për harmonizimin e terminologjisë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze;
6. Ofron vlerësim dhe ndihmë gjuhësore për stafin e Gjykatës gjatë procesit të rishikimit duke u dhënë mendime dhe këshilla *ad hoc*;
7. Merr pjesë në takimet profesionale, shpjegon çdo vështirësi në lidhje me terminologjinë të identifikuar në hartime specifike dhe kur është e përshtatshme arsyeton zgjidhjet e propozuara;

8. Menaxhon rrjedhën e punës së njësisë kur Drejtori dhe/ose Menaxheri mungojnë;
9. Promovon vlerat e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës brenda dhe jashtë saj.

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Përgatitje universitare, preferohet në fushën juridike, gjuhës apo administrimit publik; dhe
- Së paku 10 (dhjetë) vite përvojë përkatëse profesionale në përkthim.

Specialist i Shërbimeve Gjuhësore duhet të ketë aftësi për të punuar brenda afateve të shkurtra në mënyrë të pavarur; të ketë aftësi për të trajtuar në mënyrë të duhur informatat e besueshme, të jetë energjik, të ketë shkathtësi të mira ndërnjerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës, Shkathtësia dhe aftësia në përdorimin e kompjuterit dhe të softuerëve aplikativë, si: MS Word, duke përfshirë përpunimin e avancuar të tekstit, MS Excel dhe MS Outlook, është e domosdoshme.

Procedura e konkurrimit:

I brendshëm (Avancim)

Procedura e konkurrimit është e hapur për gjithë personelin kushtetues administrativ ekzistues në Gjykatën Kushtetuese të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të avancimit për gjithë personelin ekzistues brenda Gjykatës.

Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Rregulloren e punës Nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 04/2015, për Procedurat e rekrutimit, të emërimit dhe të punës provuese të stafit të Gjykatës Kushtetuese dhe Rregulloren Nr. 01/2016 për avancimin dhe transferimin e stafit të GJKK-së.

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org; nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese (DABNJ) në kopje fizike.

Konkursi i brendshëm mbetet i hapur 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës dhe në tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data 15.09.2021 deri më datën 22.09.2021, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 22 shtator 2021, deri në ora 16.00.

Shënim:

Aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.